

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar, Afrim Shala dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarve S.P. dhe N.P., që të dy nga fshati ..., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit S.P., avokatit M.K., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.780/2014, të datës 19 janar 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 22 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit S.P., avokatit M.K., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.780/2014, i datës 19 janar 2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin e lartcekur, të akuzuarit S.P. dhe N.P., i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe të njëjtit, secili veç e veç janë dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muaj, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të akuzuarit në afat prej 1 (një) viti nuk kryejnë ndonjë vepër penale tjetër.

Të akuzuarit S.P. dhe N.P., secili veç e veç janë detyruar në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 40 Euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 15 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjithashtu, të akuzuarit S.P. dhe N.P., janë detyruar që të dëmtuarit t'ia lirojnë pronën dhe mos ta pengojnë në shfrytëzimin e saj, në të kundërtën kushti

secilit veç e veç do t'ju revokohet, ashtu që të njëjtit do të shkojnë menjëherë në mbajtje të dënimit të cekur më lartë.

Pala e dëmtuar D.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i mbrojtësi i të akuzuarit S.P., avokati M.K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit për dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta aprovojë ankesën si të bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të refuzohet aktakuza në tërësi si e pabazuar, apo të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.350/2018, të datës 16 prill 2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit S.P., avokatit M.K., të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe ankesën e të akuzuarit Z.Z., konstatojë se:

- ankesa është e pabazuar.

Në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit S.P., avokatit M.K., theksohet se në këtë çështje penale kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar dispozitat ligjore, ngase me administrimin e provave nuk është vërtetuar se i akuzuari S.P. ta ketë kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë. Nga shkresat e lëndës C.nr.616/08 vërtetohet se i akuzuari është pronar legjitim mbi bazën e shitblerjes dhe i njëjti vazhdimisht ka qenë me mirëbesim bazuar në kontratën mbi shitblerjen të cilën e ka lidhë me pronarin e pronës e cila kontratë në ndërkohë është shpallur nule. Kështu që në këtë çështje nuk ka element të veprës penale dhe mungon dashja e qëllimi për uzurpim të pronës së huaj. Aktakuza është dashur që të ngritet ndaj I.J. i cili me kontratë shitblerje e ka vu në mashtrim të akuzuarin. Kjo çështje nuk konsiderohet çështje penale, ngase ka të bëjë me vërtetim pronësie dhe si e tillë është dashur të trajtohet edhe nga Prokuroria e Shtetit. Mos deklarimi i të akuzuarve në shqyrtimin e fundit pa u ballafaquar me të dëmtuarin, si dhe mosrespektimi i gjykatës nga ana e të dëmtuarve duke mos ju përgjigjur ftesave të saj është një argument shtesë se aktakuza nuk ka bazë të shëndoshë juridike dhe mu për këtë gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat ligjore të KPP, duke mos e ballafaquar të dëmtuarin me të akuzuarin. Shkelja e ligjit penal qëndron në atë se gjykata në shqyrtimin gjyqësor të datës 11.01.2018 nuk ka mundur që t'i lexojë deklaratat e mëparshme sepse palët në procedurë nuk janë pajtuar për një gjë të tillë.

Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike konsiston në atë se kjo çështje është parashkruar sepse dëmi nuk është permanent siç është rasti tek uzurpimi i pronave, ngase të akuzuarit nuk janë në posedim të pronës dhe në këtë çështje nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë qenë duke e mbajtur pronën kontestuese. Gjykata është

dashur të vërteton në vendin e ngjarjes dhe të konstatojë se kush është në posedim të pronës. Sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal në ankesë theksohet se vendimi për dënim me kusht është i pabazuar me ligj, sepse nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të akzuarit S.P., avokatit M.K. janë të pabazuara, për arsyet që do të paraqiten në vijim.

Është i pabazuar pretendimi ankimor se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të ligjit penal. Përkundrazi, Gjykata e Apelit e Kosovës konstatojë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban asnjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, e as shkelje të ligjit penal të dëm të të akzuarit, shkelje këto për të cilat Gjykata e Apelit e Kosovës kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare. Nga të gjitha provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se veprimet e të akzuarit S.P., i përbëjnë të gjitha elementet e veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, të cilën veprën penale i akuzuari Sali e ka kryer me dashje dhe në bashkëkryerje me të akzuarin N.P.. Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka bazuar në prova të ligjshme dhe përfundimet e saj i ka nxjerr pas administrimit dhe vlerësimit të të gjitha provave që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale.

Nuk qëndron as pretendimi tjetër ankimor, se kinse gjykata e shkallës së parë nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të KPP, kur ka vendosur që t'i lexojë deklaratat e dhëna në procedurat e mëparshme. Kjo për faktin se nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 11 janar 2018, por edhe nga shkresat tjera të lëndës shihet se gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të sigurojë prezencën e të dëmtuarit D.D. dhe dëshmitarit F.D., gjë që argumentohet edhe me raportet zyrtare të zyrtarëve të Policisë së Kosovës. Andaj, nën këto rrethana, gjykata e shkallës së parë duke e aplikuar nenin 338 të KPP, kishte marrë aktvendim që të lexohen deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitarit të lartcekur. Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka vendosur që të lexohen deklaratat e lartcekura, ngase një mundësi e tillë është e parashikuar edhe në nenin 338 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. të KPP.

Gjithashtu, është i pabazuar edhe pretendimi i mbrojtësit se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale, për faktin se i akuzuari S.P. është akuzuar dhe shpallur fajtor që këtë veprën penale e ka kryer që nga data 3 korrik 2014 e tutje, ndërsa për shkak të natyrës së kësaj vepre penale, dënimin që është parashikuar për këtë veprën penale dhe veprimeve të vazhdueshme që e përbëjnë figurën e kësaj vepre penale, Gjykata e Apelit e Kosovës konstatojë se nuk ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale. Në anën tjetër, nga provat që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se prona e uzurpuar tani është e evidentuar në regjistrin kadastral në emër të të dëmtuarit D.D.,

pas përfundimit të procedurës kontestimore C.nr.616/2008 dhe se të akuzuarit Sali dhe N.P., e kishin uzurpuar këtë pronë të të dëmtuarit, madje duke e shënuar në shtëpinë e të dëmtuarit edhe mbishkrimin “Pronë e S.P. ..ë”. Fakti se prona e të dëmtuarit ka qenë e uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme, vërtetohet edhe nga fakti se i dëmtuari disa herë kishte kërkuar që t’i lirohet prona edhe me ndërmjetësues, por të akuzuarit kanë refuzuar, duke vazhduar që ta mbajnë këtë paluajtshmëri në mënyrë të kundërligjshme. Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, ngase nga provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit Sali dhe N.P., e kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor, duke e uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme ngastrën kadastrale me nr.595/2, e cila është pronë e të dëmtuarit D.D., nga Deçani. Andaj, edhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë i ka detyruar të akuzuarit Sali dhe N.P., që të dëmtuarit t’ia lirojnë pronën dhe mos të pengojnë në shfrytëzimin e saj, në të kundërtën kushti secilit veç e veç do të ju revokohet, ashtu që të njëjtit do të shkojnë menjëherë në mbajtje të dënimit të cekur më lartë.

Lidhur me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit S.P. është në harmoni me peshën e veprës penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.341/2018, Më 22 maj 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,
Gani Zabeli

Shqipe Qerimi